



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 1203/1 Prot.
04.22.10.2025



UNIVERSITETI I VLORËS
ISMAIL QEMALI

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Nr. 117/36 Prot.

SPITALI PSIKIATRIK

"ALI MIHALI" VLORË

Nr. 1969 Prot.
Data 26.09.2025

MARREVËSHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

DHE

SPITALIT PSIKIATRIK "ALI MIHALI" VLORË

Nisur nga interesi i përbashkët i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë në zhvillimin e aktiviteteve me karakter arsimor, kulturor, rekreativ dhe bashkëpunues në të dy institucionet hartohet kjo marrëveshje bashkëpunimi midis:

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, institucion i arsimit të lartë publik, me adresë: Sheshi "Pavarësia", Skele-Vlorë, përfaqësuar nga Prof. Dr. Aurela Saliaj, Rektor i Universitetit

dhe

Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me adresë: Lagja "Pavaresia", Rruga "Ibrahim Avdulla", Vlorë, përfaqësuar nga Drejtor Znj. Marjola Muhaj.

Palët angazhohen për të bashkëpunuar me njëri – tjetrin mbi bazën e parimit të reciprocitetit duke rënë dakort si më poshtë:

Neni 1

Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë përcaktojnë dhe rregullojnë me këtë marrëveshje hapësirat dhe çështjet e bashkëpunimit të ndërsjelltë, si dhe format dhe mënyrat e zbatimit të saj.

Neni 2

Pjesë e këtij bashkëpunimi do të jenë:

- Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
- Shërbimi i Psikiatrisë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ky bashkëpunim përfshin realizimin e programeve mësimore në dy cikle studimi:

- Cikli i parë i studimeve të nivelit Bachelor
- Cikli i dytë i studimeve të nivelit Master (profesional dhe shkencor)

Neni 3

Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në këto fusha:

- Leksionet dhe seminarët në module mësimore të caktuara
- Praktika mësimore
- Praktika profesionale
- Projektet kërkimore klinike
- Detyrat e kursit mbi bazën e ekzaminimit të rasteve klinike.

Neni 4

Format dhe mënyrat e bashkëpunimit do të përfshijnë:

- Vënien në dispozicion të personelit mjekësor dhe infermieror të spitalit për mësimdhënie në modulet e programeve mësimore të FSH.
- Angazhimin e studentëve të FSH në procedurat infermiere të institucionit (nga marrja e anamnezës deri tek ndjekja e terapisë).
- Bashkëpunimin e pedagogëve të FSH, personelit mjekësor dhe infermieror të Spitalit, si dhe studentëve për realizimin e detyrave të kursit, projekteve klinike dhe kërkimit shkencor mjekësor.
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për Edukimin në Vazhdimësi (konferenca, simpoziume, trajnime, workshop-e).
- Sigurimin e praktikave klinike (mësimore dhe profesionale) të programeve të fushës së shëndetit, të ofruara nga FSH.

Neni 5

Secila palë e Marrëveshjes do të caktojë një person ndërlidhës për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose të programeve specifike.

Neni 6

Personeli i Fakultetit të Shëndetit, studentët e programeve mësimore të FSH si dhe personeli mjekësor i Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë janë të detyruar të zbatojnë kushtet e kësaj Marrëveshjeje, për të cilat është rënë dakord nga titullarët e të dy institucioneve.

Neni 7

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje institucionet nuk nënkuptojnë asnjë detyrim financiar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 8

Amendamentet e mundshme ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje do të formulohen dhe parashtrihen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të Marrëveshjes.

Neni 9

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjes të punës, çrregullimeve civile, motit të keq, forcës madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme, të shkaktuara përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 10

Kjo Marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit.

Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo Marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.

Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet nga secili prej institucioneve paraqet 6 (gjashtë) muaj përpara një kërkesë me shkrim drejtuar institucionit partner.

Neni 11

Kjo Marrëveshje gjen zbatim me nënshkrimin nga përfaqësuesit respektivë ligjorë të të dy institucioneve.

Kjo Marrëveshje është hartuar në 2 (dy) kopje ekzemplare në gjuhën shqipe. Të gjitha tekstet janë njëjloj të vlefshme.

Vlorë më 16.10.2025

PËR

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR

PROF.DR. AURELA SALIAJ



PËR

SPITALIN PSIKIATRIK VLORE

DREJTOR

MARJOLA MUHAJ

